



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS



V E N D I M

Nr. 29, datë 02.06.2016

“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore dhe e dëmeve në orendi të familjes së Z.Hiluk Gaci , banor i Qytetit Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes”

Bashkia Vau i Dejës pas shqyrtimit të procesverbalin nr. 149 date 05.02.2015 “Per konstatim të dëmeve të shkaktuara në banesën e djegur” të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve (bashkëngjitur), Shkresën “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe paisjeve elektroshtëpiake” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkoder (bashkëngjitur); Preventivit për “Vlerësimi i dëmeve nga ana ndërtimore”, të hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkoder (bashkëngjitur).

Bazueshmeria ligjore: ligjit Nr.139/2015, “Per vetqeverisjen vendore”; Ligjin nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e dëmeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore”, Udhezimi i perbashket Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 24.05.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e dëmeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore”: Udhezimit nr.4 date 30.09.2015 te KM “Per miratimin e koston mesatare te ndertimit te banesave nga Enti Kombetar i Banesave per vitin 2015”, pas propozimit të Zyrës së Emergjencave Civile të Bashkisë Vau i Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga stuhia dhe era e ndodhur me datë 29.01.2015 në familjen Z.Hiluk Gaci , banor i Qytetit Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes, të përbërë me 5 anëtar, Keshilli i Bashkisë më shumicë të cilësuar votash , në mbledhjen e datës 02.06.2016:

V E N D O S I:

1. Vlera e dëmit nga ana ndërtimore është në shumën 1176989 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) leke sipas preventivit të hartuar nga specialistët e Këshillit të Qarkut “Preventiv për vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore” dhe të miratuara nga Këshilli i Qarkut Shkoder.
2. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është në shumën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) leke, sipas shkresës “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe paisjeve elektroshtëpiake” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkoder
3. Ti popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës me vendimin nr. nr.7/1 datë 03/04/2015 në vlerën




10000 lekë (bashkëngjitur) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orëdi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Emergjencave Civile.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

6. U shpall sot me datë 10.06.2016



SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU